

POZICION VAKANT

Balkan Finance Investment Group, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi dhe Holandë, me afërsisht 6'000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

Kompania Mane TCI, pjesë e Grupit BALFIN, është lider në ndërtim dhe investim të projekteve zhvilluese, në Shqipëri dhe rajon. E themeluar në vitin 2001, Mane TCI është e specializuar në fushën e ndërtimeve civile dhe industriale si: Qendra Tregtare, Godina Rezidenciale, Qendra Sociale dhe Kulturore, ndërtime industriale dhe infrastrukturë.

Pozicioni: Specialiste e Lartë Finance

Departamenti: Financë

Vendndodhja: Tiranë

Përmbledhja e Pozicionit: Specialiste e Lartë Finance ndjek nga pikëpamja financiare dhe monitoron projektin dhe raportimet që lidhen me këtë shoqëri. Kontrollon kontabilizimin e faturave të blerjes dhe shitjes në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi. Ndjekjen e marrëdhënies me bankat (kredia, pagesat, si edhe plotësimin e setit të dokumenteve shoqërues sipas procedurave). Ndjekja e raportit të kontratave dhe arkëtimeve të klientëve. Kontrollon në mënyrë të detajuar shpenzimet dhe të ardhurat mujore të realizuara të projektit përkatës që ka në ndjekje.

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Kontrollon kontabilizimin e faturave të blerjes dhe shitjes në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi;
- Ndjek deklarimet mujore të Librave të blerjes dhe të shitjes, TVSH, tatim në burim;
- Rakordon dhe kontrollon llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme në mënyrë periodike;
- Ndjekja e raportit të kontratave dhe arkëtimeve të klientëve (kontrata/arkëtim);
- Krijon, koordinon dhe monitoron raportet që gjeneron departamenti i financës në përputhje me kërkesat e menaxhimit të shoqërisë;
- Analizon dhe ndjek zbatimin e procedurave të departamentit, sugjeron ndryshime për procedurat ekzistuese në funksion të punës;
- Asiston në përgatitjen e Cash flow të shoqërisë në mënyrë periodike;
- Kryerjet e pagesave me bankë & plotësimi i dosjes së bankës & kontabilizimi i tyre;
- Ndjekjen e marrëdhënies së kredisë për financimin e investimit të projektit;
- Kontrollon në mënyrë të detajuar shpenzimet dhe të ardhurat mujore të realizuara të projektit përkatës që ka në ndjekje;
- Asiston në përgatitjen e pasqyrave financiare mujore dhe vjetore;
- Punon me auditorët e shoqërisë gjatë proceseve audituese ;
- Asiston në përgatitjen e buxheteve vjetore, si dhe Biznes Planeve;
- Çdo detyrë tjetër që i caktohet.

Edukimi: Të ketë diplomë universitare në degën Financë ose/dhe Kontabilitet.

Kualifikime të tjera

- Të ketë jo më pak se 5 vite eksperiencë në pozicione të ngjashme;
- Të ketë njohuri të mira të Standardeve të reja Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IFRS);
- Të jetë i/e aftë të punojë pa/ose me pak supervizim;
- Të ketë iniciativë, të jetë komunikues, të punojë mirë në grup dhe nën stres;
- Të jetë i/e orientuar për të ndjekur problemet dhe për të arritur zgjidhjen përfundimtare;
- Të zotërojë programin Navision, si dhe të ketë njohuri të mira të programit Financa 5;

- E preferueshme njohja e gjuhës angleze;
- Eksperiencë e mëparshme pune në kompani ndërtimi/investimi është favorizuese;

Mënyra e aplikimit:

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre dhe letrën e motivimit brenda datës 1o Janar 2022 në adresën e email-it hr@manetci.al me subjekt **MTCI Specialist i lartë Finance**.

Afati i dorëzimit: 10/01/2022

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr. 9887, vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*